



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Ekstra 71

Nëntor

2010

Vendime të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut

Vendim i GJEDNJ	Mbi pranueshmërinë e an kimit nr.49130/06 nga Id riz Shat eli dhe të tjerë kundër Shqipërisë.....	3
Vendim i GJEDNJ	Mbi pran ueshmërinë e anki mit nr.23276/04 nga Sadd am Hussein kundër Shq i përisë, Bullg arisë, Kroaci së, Republikës Çeke, Da nimarkës, E stonisë, Hungarisë, Islan dës, Irlandës,Italisë, Leto nisë, L ituanisë, Holand ës, Polon isë, Portugalisë, Ru manisë, Sllovakis ë, Sllovenis ë, T urqisë, Ukrainës dhe Mbretërisë së Bashkuar.....	5
Vendim i GJEDNJ datë 27 maj 2010	Ankimi nr. 847/05 “Çështja Berhani kundër Shqipërisë”	8

SEKSIONI I KATËRT

VENDIM PRANUESHMËRIE

Ankimi nr. 49130/06
nga Idriz Shateli dhe të tjerë
kundër Shqipërisë

Gjykata Europiane (seksioni i katërt), në seancën e datës 24 gusht 2010, me përbërjen si dhomë e formuar nga:

Nicolas Bratza, kryetar,

Lech Garlicki,

Giovanni Bonello,

Ljiljana Mijović,

Päivi Hirvelä,

Ledi Bianku,

Nebojša Vučinić, gjyqtarë

dhe Fatos Araci, zëvendësregjistruer,

duke pasur parasysh ankimin e mësipërm paraqitur më 10 nëntor 2006,

duke pasur parasysh vërejtjet dhe observacionet e paraqitur nga qeveria e paditur,

pas shqyrtimit, vendosi si vijon:

FAKTE

Ankuesit, z. Idriz Shateli, z. Përparim Shateli, z. Ali Shateli, z. Shpëtim Shateli, z. Kasem Mici, z. Selman Mici, janë shtetas shqiptarë, të cilët jetojnë në Tiranë. Qeveria Shqiptare (Qeveria) është e përfaqësuar nga agjentja e saj znj. E. Hajro.

A. Rrethanat e rastit

Faktet e rastit, siç janë parashtruar nga ankuesit, mund të përmbliken si më poshtë:

Më 20 prill 1993, komunat e Vorës dhe Kasharit ranë dakord që një numër i caktuar parcelash toke (të cilat më vonë iu dhanë ankuesve) do të transferoheshin në njësinë administrative të Komunës së Kasharit. Komisioni i Tokës së Tiranës zyrtarizoi këtë transferim me vendimin nr.2 të datës 20 qershor 1996.

Më 3 shtator 2004, Komisioni i Tokës së Këshillit të Qarkut Tiranë vendosi të shpallte pavlefshmërinë e vendimit të Komisionit të Tokës së Tiranës të datës 20 qershor 1996, pasi ai ishte marrë në shkelje flagrante të një vendimi të Këshillit të Ministrave. Ky i fundit caktonte Seksionin e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës për të trajtuar detyrimet që lindnin nga vendimi (pika 2).

1. Rrethanat e rastit lidhur me ankuesin z. Idriz Shateli

Më 10 shtator 1996, Komisioni i Tokës i njohu z. Idriz Shateli të drejtën e pronësisë mbi dy parcela toke me sipërfaqe prej 17.100 m². Rezulton se ankuesi është përpjekur që të regjistrojë parcelën e tokës në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP), në përputhje me ligjin e brendshëm, por nuk ia ka dalë mbanë.

Në një datë të paspecifikuar, ankuesi ngriti një padi civile, me anë të së cilës kërkoi një urdhër për regjistrimin e parcelave të tij të tokës në ZRPP. Më 11 korrik 2002, Gjykata e Rrethit Tiranë vendosi në favor të ankuesit dhe urdhëroi ZRPP të regjistrojë parcelat e tij të tokës. Më 6 mars 2003, Gjykata e Apelit Tiranë la në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit.

Meqenëse nuk u paraqit ndonjë ankim tjetër, vendimi i Gjykatës së Rrethit Tiranë u bë përfundimtar dhe i zbatueshëm jo më vonë se data 7 prill 2003.

2. Rrethanat e rastit lidhur me ankuesit e tjerë

Më 10 shtator 1996, Komisioni i Tokës i ka njohur z. Përparim Shateli, z. Ali Shateli, z. Shpëtim Shateli, z. Kasem Mici dhe z. Selman Mici, të drejtën e pronësisë mbi një parcelë toke, përkatësisht me sipërfaqe prej 4.700 m², 4.800 m², 4.600 m², 4.300 m², 3.300 m².

Rezulton se ankuesit janë përpjekur për të regjistruar parcelat e tyre të tokës në ZRPP, në përputhje me ligjin e brendshëm, por nuk ia kanë dalë mbanë.

Në një datë të paspecifikuar, ankuesit ngritën një padi civile, me anë të së cilës ata kërkuan një urdhër për regjistrimin e parcelave të tyre të tokës në ZRPP. Më 8 tetor 2004, Gjykata e Rrethit Tiranë vendosi në favor të ankuesve dhe urdhëroi ZRPP të regjistrojë parcelat e tokës së tyre. Më 12 maj 2006, Gjykata e Lartë rrëzoi ankimin e paraqitur nga zyra e ZRPP-së Tiranë dhe la në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit të datës 8 tetor 2004. Vendimi në fjalë u bë përfundimtar dhe i zbatueshëm, pasi asnjë ankim kushtetues nuk u paraqit kundër tij.

3. Procedurat lidhur me ekzekutimin e vendimeve të gjykatave vendase

Procedurat në lidhje me ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës së Rrethit Tiranë, përkatësisht të datës 6 mars 2003 dhe 12 maj 2006 kishin filluar në një datë të paspecifikuar.

Më 26 maj 2006, ZRPP, Tiranë njoftoi zyrën e përmbarimit se dokumentet që kërkoheshin për regjistrimin e parcelave të tokës së ankuesve ishin të paplota. Në letrën e saj, ZRPP, Tiranë i është referuar vetëm vendimit të Gjykatës së Rrethit të datës 8 tetor 2004. Ajo shtoi se vendimi i gjykatës së rrethit të datës 8 tetor 2004 nuk mund të ekzekutohej, si pasojë e moszbatimit të pikës nr. 2 të vendimit të Komisionit të Tokës të datës 3 shtator 2004 (shih më lart).

Më datë 1 qershor 2006, zyra e përmbarimit informoi ZRPP, Tiranë se kishin filluar procedurat në lidhje me ekzekutimin e dy vendimeve përfundimtare të gjykatës. Zyra e përmbarimit urdhëroi ZRPP, Tiranë të procedonte me zbatimin e vendimeve të gjykatës së rrethit brenda 10 ditëve nga marrja e letrës.

Më 24 tetor 2006, zyra e përmbarimit i dërgoi një letër tjetër ZRPP, Tiranë, duke i kërkuar zbatimin e vendimeve të gjykatës brenda 10 ditëve.

Sot, akoma duket sikur asnjë nga vendimet e gjykatës nuk është ekzekutuar.

ANKESA

Ankuesit ankohen në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës dhe të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës, lidhur me moszekutimin e vendimeve të Gjykatës së Rrethit Tiranë të datave 11 korrik 2002 dhe 8 tetor 2004.

E DREJTA

Nëpërmjet letrës së datës 15 qershor 2009, vërejtjet e Qeverisë iu dërguan ankuesve, të cilëve iu kërkuar të paraqisnin në përgjigje çdo koment të tyre së bashku me çdo pretendim për shpërblim të drejtë brenda datës 25 korrik 2009. Në vëmendje të ankuesve është sjellë rregulli 36 §§ 2 dhe 4 i Rregullave të Gjykatës, sipas të cilave ankuesit duhet të përfaqësoheshin nga një “avokat”, përpara Gjykatës në këtë fazë të procedimeve.

Nëpërmjet letrës së datës 7 janar 2010, të dërguar me anë të postës së regjistruar, ankuesit janë njoftuar se ata duhet të paraqisnin formularin e plotësuar të përfaqësimit në pajtim me rregullin 36 §§ 2 dhe 4 deri më 28 janar 2010. Letra e datës 15 qershor 2009, iu bashkëngjiti për informim, në rast se ankuesit nuk e kishin marrë më parë atë. Në vëmendje të ankuesve u soll edhe fakti se dështimi për t'u përgjigjur do të shkaktonte heqjen e rastit të tyre nga lista e rasteve për gjykim të Gjykatës, ku rrethanat çuan në përfundimin se ankuesit nuk kishin më qëllim të ndiqnin ankesën e tyre. Ankuesit e morën këtë letër më 15 janar 2010. Gjithsesi, deri më sot nuk ka pasur një përgjigje nga ana e ankuesve.

Gjykata vlerëson se, në këto rrethana, ankuesit mund të konsiderohen se nuk dëshirojnë më të ndjekin ankimin e tyre, sipas kuptimit të nenit 37 § 1 (a) të Konventës. Për më tepër, në pajtim me nenin 37 § 1 *in fine*, Gjykata nuk gjen asnjë rrethanë të veçantë që ka të bëjë me respektimin e të drejtave të njeriut siç përcaktohen në Konventë dhe në protokollin e saj, që kërkojnë vazhdimin e shqyrtimit të ankimit. Për sa më sipër, është e përshtatshme që rasti të hiqet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata njehzëri:

- Vendos të heqë ankimin nga lista e rasteve për gjykim.

Fatos Araci

Zëvendësregjistruer

Nicolas Bratza

Kryetar

SEKSIONI I KATËRT

VENDIM MBI PRANUESHMËRINË E

Ankimit nr. 23276/04

nga Saddam Hussein

kundër

Shqipërisë, Bullgarisë, Kroacisë, Republikës Çeke, Danimarkës, Estonisë, Hungarisë, Islandës, Irlandës, Italisë, Letonisë, Lituanisë, Holandës, Polonisë, Portugalisë, Rumanisë, Sllovakisë, Sllovenisë, Turqisë, Ukrainës dhe Mbretërisë së Bashkuar

Gjykata Europiane (seksioni i katërt) në seancën e datës 14 mars 2006, me përbërje si dhomë e formuar nga:

z. J. Casadevall, kryetar,

z. Nicolas Bratza,

z. M. Pellonpää,

z. R. Maruste,

z. S. Pavlovschi,

z. J. Borrego Borrego,

z. J. Šikuta, gjyqtarë

dhe Z. M. O'Boyle, regjistruer seksioni,

duke pasur parasysh ankimin e mësipërm paraqitur më 29 qershor 2004,

duke pasur parasysh refuzimin për masa të përkohshme, të kërkuara sipas Rregullit 39 të Rregullave të Gjykatës,

duke pasur parasysh përparësinë që i bashkëngjitet këtij rasti (rregulli 41) dhe konfidencialitetin e dosjes së çështjes (rregulli 33), ky i fundit është akorduar në mënyrë që të shmanget zbulimi i identitetit të përfaqësuesve ligjorë të ankuesit;

pas shqyrtimit, vendosi si vijon:

FAKTE

Ankuesi, z. Saddam Hussein, është një shtetas irakian që ka lindur më 28 prill 1937. Ai është ish-presidenti i Irakut dhe aktualisht është duke u mbajtur në paraburgim në Irak.

A. Rrethanat e rastit

Faktet e rastit, të parashtruara nga ankuesi, mund të përmbliidhen si vijon:

Më 20 mars 2003 forcat e koalicionit, të udhëhequra nga gjenerali i SHBA-së, pushtuan Irakun. Ndërsa pjesa më e madhe e forcave dhe mbështetja erdhi nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) dhe nga Mbretëria e Bashkuar (MB), do të prezumohet për qëllimet aktuale se forcat e koalicionit përfshinin mbështetje nga secili shtet i paditur gjatë periudhës përkatëse. Forcat e koalicionit ishin përbërë nga divizione, secili me përgjegjësi ushtarake për një zonë të caktuar të Irakut. Divizioni i SHBA-së kontrollonte veriun dhe zonat qendrore (këto të fundit përfshinin Bagdadin dhe krahinat e Tikritit), si dhe dy divizione multinacionale, njëri i komanduar nga MB dhe tjetri nga Polonia, të cilët ishin ngarkuar, përkatësisht, për të kontrolluar zonën jugore dhe tjetri zonën qendrore.

Në fillim të prillit, forcat e SHBA-së pushtuan Bagdadin. Më 16 prill 2003, një gjeneral i SHBA-së lëshoi një "Mesazh lirie", i cili shpallte krijimin e Autoritetit të Përkohshëm të Koalicionit (APK), një administratë civile që do të ushtronte pushtet qeverisës përkohësisht në Irak. Më 13 maj 2003, Sekretari i Përgjithshëm Amerikan i Mbrojtjes caktoi Ambasadorin Bremer si Administrator të APK-së. Më 13 korrik 2003, u krijua Këshilli Qeverisës i Irakut (KQI): Administratori i APK-ja mund të vendoste veton e tij mbi të gjitha vendimet e KQI-së. APK duhej të koordinohet me KQI-në në të gjitha çështjet që përfshinin qeverisjen e Irakut.

Më 13 dhjetor 2003, ankuesi u kap në afërsi të Tikritit nga ushtarë të SHBA-së (Divizioni i katërt i këmbësisë dhe pjesëtarë të Task Forcës 121), gjatë një operacioni të quajtur “Operacioni Red Daun”.

Më 8 korrik 2004, Këshilli i Sigurimit miratoi rezolutën nr.1546 (2004), me anë të së cilës ai miratoi formimin e një qeverie sovraane të përkohshme të Irakut, e cila do të merrte, deri në datën 30 qershor 2004, përgjegjësi të plotë dhe autoritet për qeverisjen e Irakut; mirëpriti mbarimin e pushtimit dhe pushimin e APK-së nga funksionet (gjithashtu deri në datën 30 qershor 2004), kur Iraku do të rishpallte sovranitetin e plotë të tij; vërejti, në pritje të marrjes së përgjegjësive të plotë për sigurinë nga forcat irakiane të sigurisë, se prania e një force multinacionale në Irak ishte kërkuar nga ana e Qeverisë së Përkohshme të Irakut, që ishte duke ardhur në pushtet (nenet 1, 2, 8 dhe 9 të rezolutës).

Dy ditë para datës së parashikuar, më 28 qershor 2004, autoriteti i APK-së iu transferua Qeverisë së Përkohshme të Irakut.

Më 30 qershor 2004, ankuesi u transferua nga trupat amerikane drejt Qeverisë së Irakut për t’u gjykuar.

ANKESA

Ankuesi ankohet mbi arrestimin, mbajtjen në paraburgim, dorëzimin dhe gjykimin në vazhdim ndaj tij, në bazë të neneve 2, 3, 5 dhe 6, së bashku me nenin 1 të Protokollit të Gjashtë dhe të Protokollit të Trembëdhjetë. Ankuesi pretendoi se ai do të ekzekutohej pas deklarimit të fajësisë pas një “gjykimi farsë”, për të cilin atij i mungonin edhe mjetet bazë për mbrojtjen e tij.

Ankuesi argumentoi se ai ishte nën juridiksionin e shteteve të paditura, të cilat ai i konsideronte se vazhdonin akoma të mbanin *de facto* pushtetin në Irak, edhe pas transferimit në qershor të 2004:

a) meqenëse shtetet e koalicionit ishin dhe vazhdonin akoma të ishin fuqitë pushtuese, ato ishin dhe vazhdonin akoma të ishin përgjegjëse për respektimin e të drejtave të njeriut në Irak;

b) meqenëse ai u arrestua dhe u mbajt në paraburgim dhe mbeti i paraburgosur, ai ishte dhe vazhdon të jetë nën autoritetin dhe kontrollin e plotë të shteteve të koalicionit;

c) meqenëse agjentët ushtarakë përgjegjës për trajtimin e kundërshtuar ishin dhe vazhdojnë të jenë nën kontrollin e shteteve të paditura, Banković dhe të tjerë kundër Belgjikës dhe 16 shteteve kontraktuese ((vend.) [Dh.M.], nr.52207/99), ishte, sipas ankuesit, i pasaktë dhe duhet të rikonsiderohet.

E DREJTA

Ankuesi u ankua mbi arrestimin, mbajtjen në paraburgim dhe transferimin e tij drejt autoriteteve irakiane, mbi gjykimin e tij në vazhdim, si dhe mbi rezultatit e procesit.

Ai pretendoi se ishte nën juridiksionin e të gjitha shteteve të paditura, sepse ato ishin fuqitë pushtuese në Irak, pasi ai ishte nën autoritetin dhe kontrollin e tyre të drejtpërdrejtë, apo sepse ato ishin përgjegjëse për veprimet e agjentëve të tyre jashtë shtetit. Ai argumentoi më tej se ai vazhdonte të ishte nën juridiksionin e tyre pas transferimit të autoritetit, po ashtu edhe pas transferimit të tij drejt autoriteteve irakiane në qershor të 2004, pasi shtetet e paditura vazhdonin të ishin në kontroll *de facto* në Irak.

Gjykata konsideron se argumentet mbi juridiksionin janë mbështetur në parashtrime, të cilat nuk janë të bazuara. Ndërsa ankuesi iu referua disa dokumenteve të Kombeve të Bashkuara (KB), deklaratave për shtyp dhe publikimeve akademike, këto i referoheshin, pa shtuar asgjë, partnerëve të koalicionit që vepronin së bashku. Ankuesi nuk trajtoi rolin e çdo shteti të paditur dhe përgjegjësitë e tij, apo ndarjen e punës/pushtetit midis tyre dhe SHBA-së. Ai nuk iu referua fakteve apo shtrirjes së përgjegjësive ushtarake të çdo divizioni për zonat që i ishin caktuar atyre. Ai nuk detajoi strukturën e komandave relevante midis forcave të SHBA-së dhe forcave jo të SHBA-së, përveçse iu referua komandantit të përgjithshëm të forcave të koalicionit, i cili në atë kohë ishte një Gjeneral i SHBA-së. Së fundmi, dhe më e rëndësishmja, ai nuk tregoi se cili shtet i paditur (përveç SHBA-së) pati ndonjë (dhe, nëse kështu, çfarë) ndikim apo përfshirje në arrestimin, paraburgimin, dhe

dorëzimin e kundërshtuar prej tij. Pavarësisht dorëzimit formal të autoritetit tek autoritetet irakiane në qershor 2004 dhe zgjedhjet e janarit 2005, ankuesi thjesht pohoi, pa shtuar asgjë, se ato forca qëndruan *de facto* në pushtet në Irak.

Në këto rrethana të tilla, Gjykata konsideron se ankuesi nuk ka përcaktuar se ai ishte nën juridiksionin e shteteve të paditura sipas ndonjërisht prej bazave të pretenduara. Gjykata konsideron se ankuesi nuk ka provuar se ato shtete kishin juridiksion mbi bazën e kontrollit të tyre në territorin ku kanë ndodhur shkeljet e pretenduara (*Loizidou k. Turqisë*, vendimi i datës 18 dhjetor 1996, raporte të vendimeve dhe gjykimeve, 1996, VI dhe *Qipro k. Turqisë* [GC], nr. 25781/94, *ECHR* 2001). Edhe nëse ai do të mund të kishte qenë nën juridiksionin e një shteti të paditur për shkak të mbajtjes në paraburgim të tij, ai nuk ka provuar se ndonjë nga shtetet e paditura ka pasur ndonjë përgjegjësi për, apo ndonjë përfshirje ose ndonjë rol në, arrestimin e tij dhe mbajtjen në paraburgim (*Issa dhe të tjerë k. Turqisë*, vendimi i ankimit nr. 32821/96, §§ 71-82, 16 nëntor 2004 dhe *Öçalan k. Turqisë*, [Dh.M.], nr. 46221/99, § 91, *ECHR* 2005 ...). Ky dështim për të provuar ndonjërin nga përfshirjet përbën gjithashtu një përgjigje ndaj parashtrimeve të fundit të tij në kuptimin që shtetet e paditura ishin përgjegjëse për aktet e agjentëve të tyre ushtarakë jashtë shtetit. Së fundmi, nuk ka asnjë bazë në jurisprudencën e Konventës dhe ankuesi nuk i është drejtuar asnjë parimi të njohur të së drejtës ndërkombëtare, i cili do të nënkuptonte se ai ishte nën juridiksionin e shteteve të paditura mbi bazën e vetme se ato shtete formonin në mënyrë të pretenduar pjesë të një koalicioni me SHBA, kur veprimet e kundërshtuara ishin kryer nga SHBA, kur siguria në zonën në të cilën u kryen ato veprime i ishte caktuar SHBA-së dhe kur komanda e përgjithshme e koalicionit i ishte dhënë SHBA-së.

Prandaj, Gjykata nuk e konsideron se është përcaktuar që kishte ose ka ndonjë lidhje juridiksionale ndërmjet ankuesit dhe shteteve të paditura, apo që për rrjedhojë ankuesi mund të ishte nën juridiksionin e atyre shteteve, sipas kuptimit të nenit 1 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata njëzëri:

- Vendos të deklarojë ankimin të papranueshëm.

M. O'BOYLE,
Regjistruer

J. CASADEVALL
Kryetar

SEKSIONI I KATËRT
ÇËSHTJA BERHANI KUNDËR SHQIPËRISË
(Ankimi nr.847/05)

VENDIM
Strasbourg
27 maj 2010

Ky vendim do të marrë formë të prerë në rrethanat e parashikuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Në çështjen Berhani kundër Shqipërisë,

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Katërt), e mbledhur si Dhomë e përbërë nga:

Nicolas Bratza, kryetar

Giovanni Bonello,

Gavid Thor Bjorgvinsson,

Jan Sikuta,

Paivi Hirvela,

Ledi Bianku,

Nebojsa Vucinic, gjyqtarë

dhe Fatos Araci, zëvendësregjistruer i seksionit,

pasi diskutoi në seancë me dyer të mbyllura më 4 maj 2010,

shpall vendimin e mëposhtëm, që u miratua në këtë datë:

PROCEDURA

1. Çështja lindi mbi bazën e një aplikimi (nr. 847/05) kundër Republikës së Shqipërisë, drejtuar Gjykatës, në bazë të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa) nga një shtetas shqiptar, z. Gentian Berhani (aplikanti) më 20 dhjetor 2004.

2. Aplikanti përfaqësohej nga z. P. Rama, avokat në Tiranë. Qeveria Shqiptare (Qeveria) përfaqësohej nga agjentja e saj, znj. E. Hajro, Zyra e Avokatit të Shtetit.

3. Aplikanti ankohej për padrejtësi në procedimin penal kundër tij, në bazë të nenit 6 të Konventës.

4. Më 23 qershor 2008, Kryetari i Dhomës, të cilit iu caktua çështja, vendosi të njoftojë Qeverinë për aplikimin. Në bazë të dispozitave të nenit 29 § 3 të Konventës, u vendos të shqyrtohen meritat e aplikimit në të njëjtën kohë me pranueshmërinë e tij.

5. Aplikanti dhe Qeveria paraqitën komentet e tyre me shkrim (rregulli 59 § 1).

FAKTET

1. RRETHANAT E ÇËSHTJES

6. Aplikanti lindi në vitin 1972 dhe po vuan dënimin me burg në Burgun e Tiranës në Shqipëri.

A. Arrestimi dhe lirimi më pas i aplikantit

7. Herët në mëngjesin e datës 5 korrik 1996 në një bar në Kuçovë ndodhi një vrasje e kryer nga dy persona që mbanin kokore motoçiklete.

8. Në mbrëmjen e së njëjtës ditë aplikanti u arrestua me dyshimin e vrasjes me paramendim, ndërkohë që po ecte në një rrugë dytësore. Pamja e aplikantit përputhej me përshkrimin që i ishte bërë policisë, domethënë, që njëri prej autorëve të vrasjes kishte flokë të gjata. Aplikanti u paraburgos. Autori tjetër i vrasjes mbeti i paidentifikuar dhe nuk u arrit të gjurmohet.

Dëshmitarët J., K. dhe L. i dhanë deklaratatë ekipit të hetuesve në të njëjtën ditë, në mungesë të avokatit të aplikantit. Ndërsa përmbajtja e këtyre deklaratave nuk iu dha palëve, duket se ato implikonin aplikantin në kryerjen e vrasjes.

9. Policia kontrolloi rrugën që kishte përshkuar aplikanti dhe gjeti një motoçikletë të kuqe me gomën e parme të shfryrë, pak kilometra më tutje.

10. Më 6 korrik 1996 prokurori kërkoi vleftësimin e arrestimit të aplikantit. Më 7 korrik 1996 Gjykata e Rrethit në Kuçovë urdhëroi lirimin e aplikantit për mungesë të dyshimit të arsyeshëm dhe të provave. Aplikanti u përfaqësua nga avokati i tij A.

11. Më 9 korrik 1996 prokurori depozitoi një ankim.

12. Më 19 korrik 1996 Gjykata e Apelit në Tiranë e hodhi poshtë vendimin e Gjykatës së Rrethit të Kuçovës dhe urdhëroi paraburgimin e aplikantit. Aplikanti nuk mund të arrestohej sepse ishte larguar nga vendi pas lirimimit të tij më 17 korrik 1996, nga frika e një hakmarrjeje nga të afërmit e viktimës. Duket se disa vite para vrasjes, viktimë kishte vrarë vëllanë e aplikantit.

Procesverbalet e hetimit të vendit të ngjarjes dhe raporte të tjera

13. Një raport për ekzaminimin dhe mbledhjen e provave materiale të datës 5 korrik 1996 (procesverbal për këqyrjen dhe sekuestrimin e provave materiale) përmbante të dhëna për gjetjen e shtatë gëzhjojave në vendin e ngjarjes, të cilat u morën për ekzaminim balistik. U raportua se autorët e vrasjes kishin qenë në një motoçikletë të kuqe dhe njëri prej tyre kishte flokë të gjata.

14. Një raport i kontrollit trupor (procesverbal i kontrollit personal) të aplikantit në kohën e arrestimit deklaronte se u gjet se ai kishte "...një rrip me një tokëz metalike." Asnjë send tjetër nuk shënohet në këtë raport të kontrollit personal.

15. Një raport tjetër për shqyrtimin dhe mbledhjen e provave materiale përmbante të dhëna për një motoçikletë Suzuki të gjetur në anë të rrugës midis Kuçovës dhe Fierit.

B. Procesi gjyqësor

16. Nuk ka informacion të dokumentuar për ndonjë zhvillim nga data 19 korrik 1996 deri më 6 janar 1997. Duket se në një datë të paspecifikuar procesi u transferua në Gjykatën e Rrethit të Beratit (Gjykata e Rrethit).

17. Më 6 janar 1997 aplikanti u deklarua i arratisur, pas përpjekjeve të pasuksesshme të policisë për gjetjen e tij. Gjykata caktoi avokatin B. për ta përfaqësuar aplikantin.

18. Të gjitha seancat e planifikuara për datat 11 janar 1997 deri më 28 tetor 1998 u shtynë. Edhe dy seanca të caktuara midis datave 15 shkurt dhe 2 mars 1999 u anuluan për shkak të mungesës së prokurorit. Asnjë dëshmitar, përfshirë policët, megjithëse ishin thirrur nga gjykata, nuk u paraqit. Asnjë masë tjetër procedurale nuk u mor.

19. Më 18 mars 1999 Gjykata e Rrethit vendosi të vazhdonte procesin në mungesë. U vendos që B. të vazhdonte të mbronte aplikantin. Në të njëjtën ditë B. kërkoi që procesverbalin e kapjes në flagrancë, procesverbalin e kontrollit personal dhe procesverbalet për ekzaminimin e provave materiale gjykata t'i shpallte të pavlefshme. Mendimi i tij ishte se procesverbali i kapjes në flagrancë ishte i falsifikuar, ishte nënshkruar në një fazë të mëvonshme nga policët dhe nuk kishte nënshkrimin e aplikantit. Po kështu, ai sugjeroi se procesverbali i kontrollit personal dhe procesverbalet për ekzaminimin dhe mbledhjen e provave materiale nuk ishin hartuar nga policët gjyqësorë në pajtim me Kodin e Procedurës Penale. Asnjë dëshmitar nuk u paraqit atë ditë dhe asnjë provë tjetër nuk u shqyrtua nga gjykata.

Deklarimet e dëshmitarëve

20. Në seancën e datës 26 prill 1999 dëshmoi dëshmitari E., punonjës policie. Ai deklaroi se dëshmitari ishte arrestuar rastësisht, së bashku me një numër të rinjsh të tjerë si njëri prej të dyshuarve. Ndërsa të rinjtë e tjerë ishin liruar me fuqinë e garancisë së njohjes të dhënë nga fshatarët që u ndodhën aty pranë, aplikanti ishte dërguar në polici, sepse askush nuk mund të dilte garant për identitetin e tij. Aplikanti nuk u kontrollua nga policia në kohën e arrestimit të tij. Ai nuk kishte dijeni për ndonjë motoçikletë si ajo që ishte shënuar në procesverbalin ku ishte emri dhe nënshkrimi i tij. Avokati i aplikantit i bëri pyetje dëshmitarit.

21. Në seancën e datës 23 qershor 1999 para gjykatës u dëgjuan tre dëshmitarë.

Dëshmitari G. dëshmoi se po punonte në një karburant kur dy persona të cilët nuk i njihje, të cilët kishin hipur në një motoçikletë dhe ishin me kokore në kokë, pyetën nga një farë distance për karburant. Ai deklaroi se nuk i kujtohej ngjyra e motoçikletës apo e kokoreve. Ai nuk kishte vënë re ndonjë detaj të veçantë të personave. Nga ajo largësi nuk mund të vërente nëse goma e parme ishte e shfryrë apo jo.

Dëshmitari H. deklaroi se ishte treqind metra larg vendit të ngjarjes, kur kishte parë dy persona me kokore, njëri prej të cilëve kishte kryer vrasjen më 5 korrik 1996. Nuk ka asnjë shënim nëse ai e identifikoi aplikantin si njërin prej autorëve të vrasjes.

Dëshmitarja I. deklaroi se ndërsa po pinte kafe në ballkonin e kafenesë ku kishte ndodhur vrasja, ajo kishte dëgjuar kamerieren të ulërinte dhe ishte larguar me vrap. Ajo as kishte parë njeri të sillej në mënyrë të dyshimtë, as kishte dëgjuar uturimën e ndonjë motoçiklete.

22. Në seancën e datës 30 shtator 1999 dha dëshminë e tij dëshmitari F. Si punonjës policie ai dëshmoi se aplikanti ishte zgjedhur rastësisht, në zbatim të të dhënave që policia kishte marrë në radio. Në bazë të deklaramit të bërë nga kryetari i një fshati aty afër, u vërtetua se aplikanti kishte qenë duke drejtuar një motoçikletë të kuqe. Motoçikleta e kuqe u gjend gjashtë a shtatë kilometra larg vendit ku ishte arrestuar aplikanti. Dëshmitari dëshmoi se nuk kishte marrë pjesë personalisht në kontrollin e aplikantit.

23. Ndërmjet datave 15 tetor dhe 14 dhjetor u shtynë gjashtë seanca. Asnjëri prej dëshmitarëve, përfshirë ish-punonjës policie, nuk u paraqit, ndërkohë që përfaqësuesi i aplikantit mungoi në tre prej tyre.

24. Në seancën e datës 23 dhjetor, duke vërejtur mungesën e përsëritur të avokatit B., gjykata caktoi avokatin C. për aplikantin. Prokurori deklaroi se identiteti i kryetarit të fshatit, të përmendur në dëshminë e dëshmitarit F. më 30 shtator ishte zbuluar, por ai ishte jashtë shtetit dhe nuk mund të jepte dëshminë e tij para gjykatës.

25. Në seancën e datës 12 janar 2000 gjykata e hodhi poshtë kërkesën e avokatit të aplikantit të datës 18 mars 1999, i cili i referohej pavlefshmërisë së disa procesverbaleve. Ajo e lejoi prokurorin të procedonte me leximin e deklarimeve të J., K. dhe L., të cilët nuk ishin pyetur asnjëherë nga aplikanti apo përfaqësuesi i tij në lidhje me deklaramet e tyre. Prokurori dhe përfaqësuesi i aplikantit bënë parashtrimet e tyre përfundimtare.

2. Përfundimi i përgjithshëm i Gjykatës së Rrethit

26. Më 12 janar 2000 Gjykata e Rrethit të Beratit e shpalli aplikantin fajtor për vrasje me paramendim, duke vepruar në bashkëpunim me të tjerë, dhe për armëmbajtje pa leje. Vendimi, i cili u dha në mungesë, u mbështet në procesverbalet e mësipërme dhe në dëshmitë e dëshmitarëve E., F., G., H., I. dhe deklaramet e J., K. dhe L. Gjykata e dënoi aplikantin me tetëmbëdhjetë vjet burgim.

C. Procedura ankimore

27. Në një datë të paspecifikuar, babai i aplikantit u informua për vendimin e Gjykatës së Rrethit Berat. Më 25 shtator 2000 ai ngarkoi një avokat të bënte ankim kundër këtij vendimi. Në një datë të paspecifikuar avokati bëri ankim në Gjykatën e Apelit të Vlorës. Sipas Kodit të Procedurës Penale, afati kohor për depozitim e ankimit kundër një vendimi të gjykatës së Rrethit është dhjetë ditë.

28. Më 24 nëntor 2000 Gjykata e Apelit Vlorë e hodhi poshtë ankimin, me konstatimin se ai nuk i përmbahej afatit kohor të parashikuar. Ajo vërente gjithashtu se data kur i ishte dhenë njoftimi babait të aplikantit për vendimin e Gjykatës së Rrethit Berat, nuk mund të vërtetohej.

29. Ndërkaq, më 29 nëntor 2001 aplikanti u ekstradua nga Italia, ku ishte arrestuar në bazë të një urdhri ekstradimi të lëshuar nga autoritetet shqiptare.

30. Më 30 nëntor 2001, pasi i ishte dhënë leja e ankimit jashtë afatit kohor, aplikanti depozitoi ankim kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Berat. Ai u përfaqësua nga D., avokat i zgjedhur prej aplikantit. Aplikanti ankohej se vendimi i Gjykatës së Rrethit Berat nuk ishte plotësisht

i arsyetuar. Ai theksonte se asnjëri prej dëshmitarëve nuk e kishte akuzuar atë se kishte kryer krimin e datës 5 korrik 1996. Ai vuri në pikëpyetje se si mund të ishte identifikuar, nëse do të kishte pasur kokore motoçiklete në kokë. Po kështu, ai kundërshtoi leximin e deklarimeve të dëshmitarëve J., K. dhe L., të cilët nuk ishin marrë asnjëherë në pyetje ose ekzaminuar para Gjykatës së Rrethit.

31. Më 19 mars 2002 Gjykata e Apelit Vlorë (Gjykata e Apelit) la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Berat. Ajo hodhi poshtë kërkesën e aplikantit, duke u mbështetur në dëshmitë e dëshmitarëve dhe leximin e deklarimeve, të cilat ajo i shpalli të vlefshme. Ndër të tre gjyqtarët të cilët vendosën për çështjen, dy prej tyre (Gj.G. dhe A.M.) ishin anëtarë të trupit gjykues që kishte hedhur poshtë kërkesën e aplikantit të datës 24 nëntor 2000.

32. Më 16 prill 2002 aplikanti depozitoi ankim në Gjykatën e Lartë. Ai u ankua se procesverbal i kontrollit personal, procesverbalet për ekzaminimin dhe mbledhjen e provave materiale të marra gjatë fazës hetimore, dhe leximi i deklarimeve të dëshmitarëve të cilët nuk ishin marrë në pyetje gjatë hetimit penal, ishin të pavlefshme. Po kështu, ai argumentoi se ishte e pamundur që dëshmitarët ta kishin identifikuar atë si autor të krimit, sepse pretendohet që autori kishte veshur kokore. Për sa i përket akuzës së armëmbajtjes pa leje, ai pretendoi se gjykata nuk kishte prova që vërtetonin se ai kishte përdorur ndonjë armë.

33. Më 25 tetor 2002 Gjykata e Lartë e shpalli ankimin e tij të papranueshëm, duke përdorur formulimin standard (“arsyet e ankimit nuk përfshihen në fushën e veprimit të nenit 472 të Kodit të Procedurës Penale”).

34. Më 8 maj 2004 aplikanti depozitoi një ankesë kushtetuese. Krahas ankimit për padrejtësinë e procesit gjyqësor dhe të procedurës ankimore, ai u ankua edhe sepse trupi gjykues i Gjykatës së Apelit nuk ishte i paanshëm.

35. Më 21 qershor 2004 Gjykata Kushtetuese, në një trup gjykues prej tre gjyqtarësh, e shpalli të papranueshme ankesën e aplikantit. Ajo u shpreh se ankesat e aplikantit nuk ngrinin ndonjë çështje për proces gjyqësor të drejtë, por kishin të bënin kryesisht me vlerësimin e provave, që ishte funksion i gjykatave më të ulëta.

II. LIGJI I BRENDSHËM PËRKATËS

A. Kushtetuta

36. Kushtetuta shqiptare, në pjesën përkatëse të saj, shprehet kështu:

Neni 42§ 2

“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”

Neni 131

“Gjykata Kushtetuese vendos...”

f) në një vendim të formës së prerë ankesat e individëve që pretendojnë shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një gjykim të drejtë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave..”

Neni 142§ 1

“Vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara.”

Praktika ligjore përkatëse e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë

37. Më 21 korrik 2009 Gjykata Kushtetuese shqyrtoi ankimin kushtetues të aplikantit për shkelje të së drejtës së tij të një procesi të drejtë gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme si rezultat i ekzekutimit të vonuar të një vendimi të formës së prerë në favor të tij. Në një vendim të arsyetuar,

Gjykata Kushtetuese, në një trup të plotë gjykues, e hodhi poshtë ankesën kushtetuese duke gjetur se nuk kishte pasur shkelje të së drejtës në fjalë.

38. Nuk ka ndonjë praktikë gjyqësore në të cilën Gjykata Kushtetuese të ketë shqyrtuar kohëzgjatjen e procedimit penal.

B. Kodi i Procedurës Penale (KPP)

Neni 171

Njohja e personave

“1. Kur lind nevoja për të proceduar në njohjen e një personi, organi procedues fton atë që duhet të bëjë njohjen që të përshkruajë personin duke treguar të gjitha shenjat që mban mend dhe e pyet nëse ka qenë thirrur më parë për të bërë njohjen, si dhe për rrethana të tjera që mund të ndikojnë në vërtetësinë e njohjes.

2. Në procesverbal shënohen veprimet e parashikuara nga paragrafi 1 dhe deklaratimet e bëra nga personi që bën njohjen.

3. Mosrespektimi i dispozitave të parashikuara nga paragrafët 1 dhe 2 është shkak për pavlefshmërinë e njohjes.”

Neni 172

Zhvillimi i njohjes

1. Pasi largon atë që duhet të bëjë njohjen, organi procedues siguron praninë e të paktën dy personave sa më të ngjashëm me atë që duhet të njihet. E fton këtë të fundit të zgjedhë vendin e tij në raport me të tjerët duke u kujdesur që të paraqitet, sa të jetë e mundur, në të njëjtat kushte në të cilat do të kishte qenë parë nga personi i thirrur për njohje. Pasi paraqitet personi që do të bëjë njohjen gjykata e pyet nëse njeh ndonjërin nga ata që i paraqiten për njohje dhe, në rast se po, e fton të tregojë se cilin njeh dhe ta saktësojë nëse është i sigurt.

2. Kur ka arsye të mendohet se personi i thirrur për të bërë njohjen mund të frikësohet ose të ketë ndikime të tjera nga prania e personit që duhet njohur, organi procedues urdhëron që veprimi të kryhet pa e parë ky i fundit të parin.

3. Në procesverbal shënohen, me pasojë pavlefshmërie, mënyra e zhvillimit të njohjes. Organi procedues mund të urdhërojë që zhvillimi i njohjes të dokumentohet edhe me fotografime ose filmime.

Neni 173

Njohja e sendeve

1. Kur duhet proceduar në njohjen e provave materiale ose të sendeve të tjera që lidhen me veprën penale, organi procedues vepron duke respektuar rregullat për njohjen e personave, për aq sa mund të zbatohen.

2. Pasi gjenden, kur është e mundur, të paktën dy objekte të ngjashme me atë që duhet njohur, organi procedues e pyet personin e thirrur për njohje nëse njeh ndonjërin prej tyre dhe, në rast se po, e fton të deklarojë se cilin ka njohur dhe ta saktësojë nëse është i sigurt.

3. Në procesverbal shënohen, me pasojë pavlefshmërie, mënyra e zhvillimit të njohjes.

Neni 175

Njohja nga disa persona ose e disa personave

1. Kur disa persona thirren për të bërë njohjen e të njëjtit person ose të të njëjtit objekt, organi procedues kryen veprime veç e veç duke ndaluar çdo komunikim ndërmjet atij që ka kryer njohjen dhe atyre që duhet ta bëjnë atë më pas.

2. Kur një person duhet të bëjë njohjen e disa personave ose të disa objekteve, organi procedues urdhëron, që personi ose objekti që duhet njohur të futen ndërmjet personave ose objekteve të ndryshme.

3. Zbatohen dispozitat e neneve 171, 172 dhe 173.

39. Neni 425 përcakton objektin e shqyrtimit të ankimit nga Gjykata e Apelit. Ai parashikon që Gjykata e Apelit e shqyrton çështjen në tërësi dhe nuk kufizohet vetëm me shkaqet e paraqitura në ankim.

40. Në bazë të nenit 427, me kërkesë të njëres palë, Gjykata e Apelit ka të drejtë të rishqyrtojë drejtpërdrejt provat e mëparshme ose materialet e reja shtesë, nëse e gjykon të nevojshme.

41. Neni 428 përcakton se cilat vendime mund të merren nga Gjykata e Apelit. Ai parashikon se Gjykata e Apelit mund të vendosë rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit, ndryshimin e vendimit, prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes, ose prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

42. Vendimet e Gjykatës së Apelit mund të ankimohen në Gjykatën e Lartë në bazë të nenit 432 për këto shkaqe: a) për mosrespektimin ose për zbatimin e gabuar të të drejtës penale; b) për shkelje të cilat bëjnë që vendimi i gjykatës të shpallet i pavlefshëm, sipas nenit 128 të këtij Kodi; c) për shkelje të rregullave procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit.

43. Neni 434 parashikon që Gjykata e Lartë e shqyrton ankimin në atë shkallë që ngrihen çështjet e të drejtës në të.

E DREJTA

I. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

44. Në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës, aplikanti u ankua për mungesën e arsytimit të vendimeve të gjykatave të brendshme, kohëzgjatjen e procesit gjyqësor dhe mungesën e paanësisë nga ana e trupit gjykues të Gjykatës së Apelit të datës 19 mars 2002.

Neni 6 § 1 i Konventës, në pjesët e tij përkatëse, shprehet si më poshtë:

“Në përcaktimin e...çdo akuze penale kundër tij çdokush gëzon të drejtën e një seance gjyqësore ... të drejtë brenda një kohe të arsyeshme ... nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj.”

A. Padrejtësia e procesit gjyqësor

1. Pranueshmëria

45. Aplikanti u ankua për mungesën e arsytimit të vendimeve të gjykatave të brendshme. Asnjëra prej palëve nuk ngrii ndonjë kundërshtim paraprak në lidhje me këtë ankesë.

46. Gjykata rithekson se ajo mbështetet në karakterizimin që u jepet në ligj fakteve të çështjes. Ajo nuk e konsideron veten të detyruar nga karakterizimi i dhënë nga një aplikant apo qeveri (*shih, midis autoriteteve të tjera, Mullai dhe të Tjerët kundër Shqipërisë, nr. 9074/07, § 73, 23 mars 2010*). Gjykata çmon se, në bazë të të dhënave në dosjen e çështjes, kjo ankesë duhet shqyrtuar nga këndvështrimi i drejtësisë së procesit gjyqësor.

47. Gjykata çmon se kjo ankesë nuk është haptazi e pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Më tej, konstaton se ajo nuk është e papranueshme për ndonjë arsye tjetër. Rrjedhimisht, duhet deklaruar e pranueshme.

2. Meritat

a. Parashtrimet e palëve

48. Aplikanti parashitroi se gjykatat e brendshme nuk i kishin arsyetuar si duhet vendimet e tyre në bazë të provave vendimtare dhe përfundimtare. Për rrjedhojë, ai pretendonte se procesi gjyqësor kishte qenë i padrejtë.

49. Qeveria parashitroi se procesi gjyqësor kishte qenë i drejtë. Aplikanti kishte pasur përfitimin e procedimit kundërshtues dhe ishte përfaqësuar nga avokatë sipas zgjedhjes së tij ose të caktuar nga anëtarët e familjes së tij. Gjykatat e brendshme i kishin arsyetuar vendimet e tyre dhe e kishin shpallur aplikantin fajtor në bazë të provave të mbledhura dhe procesverbaleve.

b) Vlerësimi i Gjykatës

50. Gjykata rithekson në fillim se pranueshmëria e provave rregullohet kryesisht me rregullat e së drejtës së brendshme dhe se, si rregull, u takon gjykatave kombëtare të vlerësojnë provat para tyre, të vërtetojnë faktet dhe të interpretojnë të drejtën e brendshme. Në parim Gjykata nuk ndërhyr, përveç rasteve kur vendimet e marra nga gjykatat e brendshme duken arbitrare ose haptazi të paarsyeshme, dhe me kusht që procesi gjyqësor në tërësi të ketë qenë i drejtë, siç kërkohet nga neni 6 § 1 (*shih Caka kundër Shqipërisë, nr. 44023/02, § 100, 8 dhjetor 2009; dhe Khamidov kundër Ruisë, nr. 72118/01, § 170 KEDNJ 2007-XII (fragmente)*).

51. Më tej, gjykata rithekson se në rrethana të caktuara mund të jetë e nevojshme që gjykatat të shfrytëzojnë deklaratat e bëra gjatë fazës së hetimit penal. Nëse i akuzuari kishte mundësi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për t'i kundërshtuar këto deklaratat në kohën që u morën ose në një fazë të mëvonshme të procesit gjyqësor, përdorimi i tyre nuk bie në kundërshtim me garancitë e nenit 6 § 1 dhe 3 (d). Të drejtat e mbrojtjes kufizohen në një shkallë që është e papajtueshme me kërkesat e nenit 6, nëse dënimi bazohet vetëm ose në mënyrë vendimtare në deponimet e një dëshmitari të cilin i akuzuari nuk ka pasur mundësinë ta marrë në pyetje ose të kërkonte që ai të merrej në pyetje gjatë hetimit ose në një proces gjyqësor (*shih Vozhigov kundër Ruisë, nr. 5953/02, § 51, 26 prill 2007; Luca kundër Italisë, nr. 33354/96, § 40, KEDNJ 2001-II; dhe Sokalov kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 47023/99, § 57, KEDNJ 2001-X*).

52. Në rastin në fjalë, dënimi i aplikantit u bazua, ndër të tjera, në deklaratat e dëshmitarëve J., K. dhe L., të bëra gjatë hetimit penal. Gjykata vëren se asnjë prej këtyre dëshmitarëve nuk u paraqit para Gjykatës së Rrethit ose Gjykatës së Apelit ose nuk ishte marrë në pyetje nga aplikanti ose përfaqësuesi i tij gjatë hetimit penal. Ndërsa Gjykata nuk mund të arsyetojë në lidhje me përmbajtjen e këtyre deklaratave, pasi ato nuk u parashtruan nga palët, ato qartazi kishin rëndësi për çështjen dhe duket se kanë pasur rëndësi vendimtare në dënimin e aplikantit. Argumenti i aplikantit se ato nuk duhej të ishin marrë parasysh, me arsyen se e drejta e tij për të marrë në pyetje dëshmitarët nuk ishte respektuar, u trajtua në mënyrë të pamjaftueshme në apel (*shih Caka, cituar më lart, §§ 108 dhe 115*).

53. Për më tepër, Gjykata nuk konstaton ndonjë provë tjetër bindëse në vendimet e gjykatave të brendshme që mund të justifikonin dënimin e aplikantit.

Në radhë të parë ajo vëren se asnjë prej tre dëshmitarëve okularë, G., H. dhe I., të cilët dëshmuuan para Gjykatës së Rrethit më 23 qershor 1999 nuk e identifikoi aplikantin si autori i krimit. Së dyti, dy oficerët e policisë, E. dhe F., të cilët dëshmuuan para Gjykatës së Rrethit përkatësisht më 26 prill dhe 30 shtator, deklaruan se aplikanti ishte arrestuar rastësisht dhe ishte dërguar në polici me argumentin e përshkrimit të paqartë të dhënë nga fshatarët aty afër. Rrjedhimisht, Gjykata e ka të vështirë të kuptojë sesi fajësia e aplikantit mund të bazohet në provat e dëshmitarëve okularë, siç deklarohej nga gjykatat e brendshme.

54. Edhe po të supozohet se dëshmitarët okularë e identifikuan aplikantin si autorin e krimit, Gjykata vëren se gjykatat e brendshme nuk iu përgjigjën ankesës së aplikantit për pamundësinë e identifikimit të tij kur sulmuesi pretendohet se kishte veshur kokore. Nga dosja e çështjes duket se nuk u zhvillua asnjë paraqitje për njohje me anë të fotografisë, megjithëse KPP e rregullonte qartë në kohën përkatëse organizimin e njohjes së personave dhe sendeve. Gjykata nuk mund të gjejë ndonjë shpjegim për këtë mosveprim; as Qeveria nuk dha ndonjë sqarim në lidhje me këtë.

55. Së fundi, Gjykata nënvizon procesverbalet e ndryshme policore të depozituara gjatë hetimit penal. Në procesverbale nuk tregohet se u gjetën gjurmët e gishtërinjve të aplikantit në motoçikletën e kuqe "Suzuki" që pretendohet se ishte përdorur nga sulmuesit. As mund të përcaktohet se shtatë gëzhojat e gjetura ishin të fishekëve të shkrepur nga një armë që kishte qenë në zotërim të aplikantit. Për më tepër, nga dosja e çështjes dhe nga të dhënat që u paraqitën nga Qeveria nuk duket se autoritetet e gjetën armën e përdorur nga sulmuesit. Nuk ka referencë e jo më tentativë për të zgjidhur ndonjë prej çështjeve të mësipërme në vendimet e gjykatave të brendshme.

56. Duke pasur parasysh vlerësimet e mësipërme, Gjykata çmon se procesi gjyqësor i gjykatave të brendshme nuk i përmbushi kërkesat e drejtësisë të kërkuara nga neni 6 § 1 i Konventës dhe se, për rrjedhojë, ka pasur shkelje të kësaj dispozitë në lidhje me këtë.

B. Kohëzgjatja e procesit gjyqësor

1. Pranueshmëria

57. Qeveria argumentoi se ankesa e aplikantit për kohëzgjatjen e procesit gjyqësor duhet hedhur poshtë për mosshkrim të mjeteve të brendshme ligjore.

58. Aplikanti nuk bëri ndonjë parashtrim në lidhje me këtë.

59. Gjykata rithekson konstatimin e saj në çështjen Balliu kundër Shqipërisë (vendimi nr. 74727/01) se Gjykata Kushtetuese konsiderohet mjet ligjor efektiv për qëllimet e nenit 35 të Konventës, ku ngrihet çështja e gjykimit të drejtë. Në rastin në fjalë, aplikanti nuk e shfrytëzoi këtë mjet ligjor. Gjykata do të shqyrtojë nëse aplikantit iu kërkuar ta shteronte këtë mjet ligjor.

60. Gjykata kujton se rregulli i shterimit të mjeteve të brendshme ligjore vlerësohet, në parim, kundrejt datës së paraqitjes së aplikimit në këtë Gjykatë (*shih Marien kundër Belgjikës (vendim) nr. 46046/99, 24 qershor 2004*). Ajo rithekson konstatimet e saj në çështjen Gjonbocari dhe të Tjerët kundër Shqipërisë (nr.10508/02 §§ 73-82, 23 tetor 2007) dhe Marini kundër Shqipërisë (nr.3738/02, §§ 147-158, KEDNJ 2007-XIV (fragmente) se nuk kishte mjet ligjor efektiv në lidhje me kohëzgjatjen e procesit gjyqësor. Fakti se më 21 korrik 2009 Gjykata Kushtetuese shqyrtoi meritat e aplikimit për kohëzgjatjen e ekzekutimit të vonuar të një vendimi gjykatë të formës së prerë (*shih paragrafin 37 më lart*), nuk mjafton për të shpallur se ajo përbënte ndonjë mjet ligjor efektiv në lidhje me kohëzgjatjen e procesit penal në kohën fizike.

61. Për këtë arsye, Gjykata e hedh poshtë kundërshtimin e Qeverisë. Nuk është përcaktuar asnjë arsye tjetër për deklarimin e ankesës të papranueshme. Rrjedhimisht, Gjykata e deklaroi këtë ankesë të pranueshme.

2. Meritat

a. Parashtrimet e palëve

62. Qeveria ia atribuoi kohëzgjatjen e procesit gjyqësor trazirave civile të vitit 1997, mungesës së funksionimit normal të strukturave shtetërore në atë kohë dhe gjendjes së përgjithshme të pasigurisë, të cilat vonuan paraqitjen e dëshmitarëve në procesin gjyqësor.

63. Aplikanti u ankua se procesi i tij kishte zgjatur pothuajse tetë vjet dhe ishte përtej kërkesës së “kohës së arsyeshme”. Ai u mbrojt me argumentin se ngjarjet e vitit 1997, siç debatoheshin nga Qeveria, nuk kishin lidhje me kohëzgjatjen e procesit gjyqësor i cili ishte shtyrë përtej këtyre ngjarjeve.

b. Vlerësimi i Gjykatës

64. Periudha që duhet të merret parasysh filloi vetëm në 2 tetor 1996, kur hyri në fuqi njohja nga Shqipëria e të drejtës së kërkesës individuale. Megjithatë, në vlerësimin e arsyetueshmërisë së periudhës që kaloi nga ajo datë, duhet të merret parasysh gjendja e procesit gjyqësor në atë kohë.

65. Për më tepër, periudha gjatë së cilës aplikanti u arratis për në Itali (17 korrik 1996 deri në 29 nëntor 2001) duhet të përjashtohet nga kohëzgjatja e përgjithshme e procesit gjyqësor (*shih Eloyev kundër Ukrainës nr.17283/02, § 70, 6 nëntor 2008; Smirnova kundër Rusisë nr.46133/99 dhe 48183/99, § 81, KEDNJ 2003-IX; dhe Gironami kundër Italisë, vendim i datës 19 shkurt 1991, Seria A nr.196-E, § 13*). Periudha në fjalë filloi në 29 nëntor 2001 dhe përfundoi në 21 qershor 2004. Kështu, ajo zgjati dy vjet, shtatë muaj e njëzet e tre ditë në të tri shkallët.

66. Duke pasur parasysh kriteret e parashtruara në praktikën gjyqësore të Gjykatës (*shih, midis shumë autoriteteve të tjera, Gjonbocari dhe të tjerët kundër Shqipërisë, cituar më lart*), Gjykata nuk është e bindur se kohëzgjatja e procesit gjyqësor nuk e përmbushi kërkesën e “kohës së mjaftueshme”. Asnjë vonesë nuk mund t’i atribuohet autoriteteve gjatë asaj periudhe. Përkundrazi, ato vepruan me zell në një çështje penale që ishte mjaft e ndërlikuar.

67. Për rrjedhojë, nuk ka pasur asnjë shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në këtë drejtim.

C. Mungesa e paanshmërisë

68. Aplikanti argumentoi se fakti që dy gjyqtarë ishin pjesë e Gjykatës së Apelit më 24 nëntor 2000 dhe 19 mars 2002, nënkuptonte se trupi i fundit gjykues nuk mund të konsiderohej objektivisht i paanshëm.

69. Qeveria parashtroi se nuk kishte pasur asnjë shkelje të tillë sepse më 24 nëntor 2000 Gjykata e Apelit e kishte hedhur poshtë ankimin e aplikantit për papajtueshmëri me kërkesat formale dhe afatet kohore të parashikuara me ligj, pa shqyrtuar meritat e saj. Meritat e çështjes u shqyrtuan vetëm më 19 mars 2002.

70. Gjykata thekson se ekzistenca e paanshmërisë për qëllimet e nenit 6§1 duhet të përcaktohet nëpërmjet një testi subjektiv, domethënë në bazë të bindjes personale të një gjyqtari të caktuar në një çështje të caktuar, dhe gjithashtu nëpërmjet një testi objektiv, domethënë, përcaktimit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar ndonjë dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim (*shih, midis shumë autoriteteve të tjera, Driza kundër Shqipërisë nr.33771/02, §74 KEDNJ 2007-XII (fragmente)*).

71. Në lidhje me testin subjektiv, Gjykata rithekson se paanshmëria personale e një gjyqtari duhet të prezumohet derisa të ketë prova për të kundërtën (*shih Driza kundër Shqipërisë, cituar më lart, § 75*). Në çështjen në fjalë, Gjykata nuk është e bindur se ka ndonjë provë që gjyqtari veçoi në bazë të njëanshmërisë personale. Për rrjedhojë, ajo prezumon paanshmërinë e tyre personale.

72. Gjykata vlerëson se shtysa kryesore e ankesës së një aplikanti lidhet me mungesën e paanësisë objektive. Në bazë të testit objektiv duhet të përcaktohet nëse pavarësisht nga sjellja personale e gjyqtarit, ka fakte të vërtetueshme që mund të ngrenë dyshime në lidhje me paanshmërinë e tij. Në këtë drejtim, edhe paraqitjet mund të kenë një rëndësi të caktuar. Ajo që është në rrezik është besimi që gjykata në një shoqëri demokratike duhet të frymëzojë tek publiku, përfshirë të akuzuarin. Në vendosjen nëse ka arsye të përligjur për t'u frikësuar se një gjyqtari të caktuar i mungon paanshmëria, pikëpamja e të akuzuarit është e rëndësishme por jo vendimtare. Vendimtare është nëse kjo frikë mund të merret si e justifikuar objektivisht (*shih Driza, cituar më lart § 76*).

73. Në çështjen në fjalë, frika se trupi gjykues i Gjykatës së Apelit i datës 19 mars 2002 nuk ishte i paanshëm buroi nga fakti se dy prej tre gjyqtarëve të trupit gjykues kishin qenë më parë në trupin gjykues që kishte rrëzuar ankimin në 24 nëntor 2000, që mund të shkaktonte dyshime nga ana e të akuzuarit në lidhje me paanshmërinë e gjyqtarëve. Megjithatë, nëse këto dyshime duhet të trajtohen si objektivisht të justifikuar, kjo varet nga rrethanat e çdo çështjeje të veçantë. Thjesht fakti se një gjyqtar kishte marrë tashmë vendime të tjera në apel, nuk mund të quhet në vetvete si justifikim i shqetësimeve në lidhje me paanshmërinë e tij (*shih Castillo Algar kundër Spanjës, 28 tetor 1998, § 46, Raporte të Gjykimeve dhe Vendimeve, 1998-VIII*). Ajo që ka rëndësi është objekti dhe natyra e masave të marra nga gjyqtari në ankimet e mëparshme.

74. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se në 24 nëntor 2000 Gjykata e Apelit u kufizua në rrëzimin e ankimit të aplikantit për mospërbushje të kërkesave formale, përfshirë afatet kohore. Ajo nuk bëri ndonjë vlerësim të fakteve të disponueshme ose të provave të paraqitura, me synim rishikimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit.

75. Meritat e ankimit të aplikantit u shqyrtuan nga Gjykata e Apelit në 19 mars 2002, vetëm pasi aplikantit i ishte dhënë leja të ankimonte jashtë afatit. Në atë datë, Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoi provat e paraqitura, arriti në përfundimin se aplikanti e kishte kryer veprën penale nën akuzë, dhe la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit.

76. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pjesëmarrja e dy gjyqtarëve në miratimin e vendimit të datës 19 mars 2002 nuk e rrezikoi paanshmërinë e Gjykatës së Apelit sepse dyshimet e aplikantit nuk mund të merren si objektivisht të justifikuar (*shih, mutatis mutandis, Sainte-Marie kundër Francës, 16 dhjetor 1992, §§ 32-34, Seria A, nr.253-A dhe Morel kundër Francës, nr.34130/96, §§ 48-50, KEDNJ 2000-VI; shih a contrario, Castillo Algar cituar më lart, §§ 47-51, dhe Indra kundër*

Slovakisë, nr.46845/99, §§ 51-55, 1 shkurt 2005).

77. Rrjedhimisht, Gjykata çmon se ankesa e aplikantit në këtë aspekt të nenit 6 të Konventës është haptazi e pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 dhe kësisoj e papranueshme në bazë të nenit 35 § 4 të Konventës.

II. PRETENDIMET PËR SHKELJE TË NENIT 6§2 TË KONVENTËS

78. Në bazë të nenit 6 § 2 aplikanti u ankua se ishte prezumuar fajtor në bazë të konflikteve të vjetra ndërmjet familjes së tij dhe familjes së viktimës.

Neni 6 § 2 i Konventës parashikon:

“(…)

2. Çdokush i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij në bazë të ligjit.

(…)”

79. Gjykata rithekson se prezumimi i pafajësisë shkelet nëse, pa u provuar më parë fajësia e të akuzuarit në bazë të ligjit, një vendim gjyqësor në lidhje me të pasqyron një opinion se ai është fajtor (*shih, për shembull, Barbera, Messegue dhe Jabardo kundër Spanjës, 6 dhjetor 1988, §91, seria A nr.146*).

80. Gjykata çmon se kjo ankesë është e pabazuar. Nuk ka prova që gjatë procesit gjyqësor gjykatat e brendshme të kenë marrë ndonjë vendim ose të kenë mbajtur ndonjë qëndrim që pasqyron fajësinë e aplikantit për shkak të konflikteve të vjetra të pretenduara ndërmjet familjes së tij dhe familjes së viktimës. Po kështu, nuk ka tregues se autoritetet bënë ndonjë deklaratë publike që do të kishte qenë e barasvlershme me shpalljen fajtor të aplikantit. Për më tepër, vendimet e gjykatave të brendshme nuk përmendin e jo më t'i referohen konfliktit të pretenduar ndërmjet dy familjeve. Së fundi, Gjykata çmon se mosdhënia e arsyeve të mjaftueshme në bazë të nenit 6§1 të Konventës nuk është në vetvete provë e ndonjë prezumimi fajësie nga ana e gjykatave të brendshme bazuar në konfliktet ndërmjet familjes së aplikantit dhe familjes së viktimës.

81. Në përgjithësi, duke pasur parasysh të gjitha materialet në zotërim të saj dhe në shkallën që çështjet për të cilat është bërë ankesa, janë brenda kompetencave të saj, Gjykata konstaton se ato nuk përmbajnë ndonjë tregues të shkeljes së nenit 6 § 2 të Konventës.

82. Rezulton se kjo pjesë e aplikimit është haptazi e pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë në pajtim me nenin 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.

III. PRETENDIMET PËR SHKELJE TË NENIT 6 § 3 TË KONVENTËS

83. Aplikanti u ankua në bazë të nenit 6§3 (a), (b) dhe (c) se: nuk ishte informuar për akuzat nga prokuroria; nuk kishte pasur kohë të mjaftueshme për t'u vetëmbrojtur; dhe nuk kishte pasur mundësi të caktonte avokat mbrojtës sipas zgjedhjes së tij sepse nuk ishte informuar për procedimin penal.

Neni 6§3 i Konventës, në pjesën përkatëse të tij, parashikon:

“3. Çdokush i akuzuar për një vepër penale gëzon këto të drejta minimale:

a) të informohet menjëherë, në një gjuhë që ai e kupton dhe në hollësi, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij;

b) të ketë kohë dhe mjete të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij;

c) ta mbrojë veten personalisht ose nëpërmjet ndihmës ligjore sipas zgjedhjes së tij ose, nëse nuk ka të ardhura të mjaftueshme për ta paguar ndihmën ligjore, kjo e fundit t'i jepet falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

(…)”

84. Gjykata çmon se kjo ankesë nuk është haptazi e pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Më tej, Gjykata konstaton se ankesa nuk është e papranueshme për ndonjë arsye tjetër. Për rrjedhojë, ajo duhet shpallur e pranueshme.

85. Megjithatë, duke pasur parasysh konstatimet e mësipërme, (shih paragrafët 50-56 më lart), gjykata nuk e çmon të nevojshme të kryejë një shqyrtim të veçantë në lidhje me ankesat në bazë të nenit 6§3.

IV. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

86. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Në rast se Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese në fjalë lejon vetëm kompensim të pjesëshëm, Gjykata, nëse e çmon të nevojshme, i ofron kompensim të drejtë palës së dëmtuar.”

A. Dëmi

87. Aplikanti kërkoi 200 000 euro në lidhje me dëmin monetar dhe 250 000 euro për dëm jomonetar.

88. Qeveria e hodhi poshtë pretendimin e aplikantit për kompensim të drejtë.

89. Në lidhje me pretendimin se është shkaktuar dëm monetar, Gjykata rithekson se duhet të ketë një lidhje të qartë shkakësore ndërmjet dëmit të pretenduar nga aplikanti dhe shkeljes së Konventës (shih, ndër të tjera, Dybeku kundër Shqipërisë, nr.41153/06, § 65, 18 dhjetor 2007).

90. Duke pasur parasysh konstatimin e saj për shkelje në lidhje me ankesën e aplikantit në bazë të nenit 6§1 për procesin e padrejtë gjyqësor, Gjykata çmon se nuk është përcaktuar asnjë lidhje shkakësore ndërmjet dëmit të pretenduar dhe shkeljes që ka gjetur Gjykata. Gjykata nuk mund të hamendësojë se cili do të kishte qenë rezultati i procesit penal kundër aplikantit nëse nuk do të kishte ndodhur shkelja. Për këtë arsye, Gjykata e çmon të papërshtatshme t'i caktojë aplikantit kompensim për dëmin monetar të pretenduar.

91. Gjykata çmon se konstatimi i shkeljes së nenit 6§1 do të thotë se nuk është demonstruar se procesi gjyqësor i gjykatave të brendshme plotësoi kërkesat e drejtësisë. Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore të vendosur, me qëllim që, në rast të një shkeljeje të nenit 6 § 1 të Konventës, aplikanti duhet, për aq sa është e mundur, të vendoset në pozitën në të cilën do të kishte qenë nëse kërkesat e kësaj dispozite nuk do të ishin marrë parasysh. Gjykata rithekson se, kur konstaton se një aplikant është dënuar pa iu siguruar ndonjë prej garancive të procesit gjyqësor të drejtë, mënyra më e përshtatshme e dëmshpërblimit do të ishte, në parim, një rigjykim ose rihapje e procesit gjyqësor, në kohën e duhur dhe në pajtim me kërkesat e nenit 6 të Konventës (*shih Xheraj kundër Shqipërisë, nr.37959/02, § 82, 29 korrik 2008; Caka kundër Shqipërisë, nr.44023/02, § 122, 8 dhjetor 2009 dhe Laska dhe Lika kundër Shqipërisë, nr.12315/04 dhe 17605/04, §§ 73-77, 20 prill 2010*). Në lidhje me pretendimin për dëmin jomonetar, duke vendosur në baza të barabarta, Gjykata i cakton aplikantit 4 800 euro plus çdo taksë që mund të vendoset mbi këtë shumë.

B. Shpenzimet

92. Aplikanti kërkoi 4 000 euro, për shpenzimet e kryera para gjykatave të brendshme dhe 7 500 Euro për shpenzimet e kryera para kësaj Gjykate. Ai nuk dha një pasqyrë të hollësishme për të argumentuar kërkesën e tij për kostot dhe shpenzimet.

93. Qeveria e kundërshtoi kërkesën.

94. Gjykata vëren se nuk i është dhënë dokumentacioni përkatës që tregon se shpenzimet e kërkuara në fakt ishin kryer. Rrjedhimisht, Gjykata nuk i cakton kompensim aplikantit nën këtë titull.

C. Interesi i munguar

95. Gjykata çmon të përshtatshme që interesi i munguar duhet të bazohet në normën marginale të interesit të huas të Bankës Qendrore Europiane, së cilës i duhen shtuar tre pikë përqindjeje.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA NJËZËRI

1. I shpall ankesat për mungesën e paanshmërisë të Gjykatës së Apelit dhe shkelje të prezumimit të pafajësisë të papranueshme dhe pjesën tjetër të aplikimit të pranueshëm.

2. Vendos se ka pasur shkelje të nenit 6§1 të Konventës për shkak të mungesës së drejtësisë në procesin gjyqësor.

3. Vendos se nuk ka pasur shkelje të nenit 6§1 të Konventës në lidhje me kohëzgjatjen e procesit gjyqësor.

4. Vendos se nuk është e nevojshme të shqyrtohet ankesa e aplikantit në bazë të nenit 6§3 të Konventës.

5. Vendos:

a) Se shteti i paditur duhet t'i paguajë aplikantit, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë, sipas nenit 44 § 2 të Konventës, shumën prej 4 800 (katër mijë e tetëqind) euro për dëmin jomonetar, që duhet të konvertohen në monedhën vendase të shtetit të paditur me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së pagesës, plus çdo taksë që mund të paguhet.

b) Se, nga skadimi i afatit tremujor të lartpërmendur deri në momentin e pagesës, mbi shumën e mësipërme të paguhet interes i thjeshtë i cili duhet të jetë i barabartë me normën marginale të interesit të huas të Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagesës, plus tre pikë përqindjeje.

6. Rrëzon pjesën tjetër të pretendimit të aplikantit për kompensim të drejtë.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 27 maj 2010, në bazë të rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullave të Gjykatës.

Fatos Araci
Zëvendësregjistruer

Nicolas Bratza
Kryetar

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK 55	lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 24.11.2010
Doli nga shtypi më 26.11.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 20 lekë